

...mjete informatike dhe jo...

...sot ekzistojnë shumë mjete informatike dhe jo për ndjekjen e leksioneve dhe për të studiuar, zgjedhim atë që mund të shërbej për ty, kompjuter, skaner, software specifik, mekanizma Braille, aparate të komunikimit alfabetik, model i fundit Dragon, Poet-compact, llamba zmadhuese, auto dhe audio lexues, sisteme fotografike me celularë që kanë sinteza zanore, tavolina që rregullohen, seanca të përshtatshme, mbështetëse librash; të caktohet në përdorim falas ai që të ndihmon për të studiuar, gjatë gjithë kohës që të nevojitet...

...përfshirje...

...i kanë ndryshuar emrin, në fillim quhej "integrim", domethënë gjithçka që mund të bëjmë për tu takuar në mënyrë reciproke: organizojmë kurse të shumëllojshme, si për shembull kurse LIS, kurse që të mesojnë si të shtosh ose forcosh besimin në veten tënde, kurse Psikoterapie, dhe kurse vetëbesimi për prindrit e tu. Organizojmë veprimtari për të bashkëbiseduar, me takime që kanë një synim, me momente të magjishme me përralla, filma, veprimtari kulturore e akoma gjëra të tjera.... Lulet tona në syth? SPORT-ELL-TUTTI, një sistem që kemi ndërtuar bashkë me Institucione të tjera për të të orientuar për të zgjedhur një sport të përshtatshëm për ty, për tu "rritur" dhe zbavitur së bashku me djem/vajza me aftësi të kufizuara dhe jo, dhe pastaj tek ne mund të gjesh dhe takosh një grup simpatik studentësh, të diplomuar në universitet, me aftësi të kufizuara dhe jo, që bejnë pjesë në Associazione Vita Indipendente (Shoqërinë Jetë e Pavarur), e cila ka lindur në Universitetin tonë dhe bën projekte për përfshirje sociale dhe kulturore...

Për çfarëdolloj njoftimi drejtohu tek:

Profesoresha Emilia Caronna
Delegat e Rektorit për
Iniciativat që i përkasin studentëve me
aftësi të kufizuara
dhe të fashave të ulta
0521 033554 – 329 0189240
emiliawanda.caronna@unipr.it

Profesori Emilio Acerbi
Delegat i Rektorit për
Orientimin e kurseve të studimit
0521 906947
emilio.acerbi@unipr.it

Doktoresha Daniela Barantani
Kryetare e Sektorit të Kontributeve
dhe të të drejtave të studimit
0521 034075
daniela.barantani@unipr.it



UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI PARMA
Via Università, 12 – 43100 Parma
Centrali 0521 032111
www.unipr.it



UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI PARMA

LE ELI-CHE
SHËRBIM PËR STUDENTË DHE STUDENTE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE TË
FASHAVE TË ULTA

...çdogjë që studentet
dhe studentët me aftësi
të kufizuara duhet të dinë
për të mbrojtur
diplomën e universitetit
në Universitetin tonë...

www.dis-abile.unipr.it
dis-abile@unipr.it

SHQIP - Albanese

...e drejta për të studiuar...

Ligji 104/92

...e drejta për arsim...

Marrëveshje e OKB-së, 2006

...janë të parashikuara nga ligji dhe nga Marrëveshja për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, dhe tashmë janë pjesë e historisë sociale dhe të komunitetit; Universiteti ynë ka 12 vjet që i realizon dhe i bën të vërteta garancitë dhe mundësitë për të ndjekur tituj akademik, për shkallën e parë për mbrojtjen e diplomës universitare...

...pranimi dhe regjistrimi...

...për të hyrë në një Kurs për të mbrojtur diplomën universitare është e nevojshme një diplomë e Shkollës së mesme, e ashtuquajtura dëftesa e pjekurisë, që mbrohet mbas 5 vjet studimi, asnjë lloj dokumenti tjetër që vërteton ndjekjen e mësimeve nuk është i vlefshëm për tu shkruajtur në Universitet...

...i shlyer nga taksat...

...duke pasur një vërtetim invaliditeti të barabartë ose më të lartë se 66 përqind, nuk paguan taksat e universitetit, por vetëm taksat e krahinës dhe ato qeveritare; në qoftë se vërtetimi i invaliditetit është më i vogël se 66 përqind, vlerësojmë bashkë çfarë mundësie të japim dhe në qoftë se i përket një fashe të ulët, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, kemi një Komision të posaçëm, të cilit mund ti bëhet kërkesë për të mos paguar taksat universitare në mënyrë totale ose të pjeshme...

...pritja dhe orientimi...

...para se të vendosësh në çfarë Kursi të shkruhesh për të mbrojtur diplomën universitare, ke mundësinë të takosh Delegaten që merret me Inicativat për studentët me aftësi të kufizuara dhe ata që i përkasin fashave të ulta dhe Delegatin që merret me Orientimin e kurseve të studimit, vlerësojmë bashkë rrugën universitare më të lehtë dhe më të përshtatshme për ty, edhe duke menduar për një veprimtari pune në një të ardhme dhe njëkohësisht të japim informacionet mbi ndihmat dhe mjetet teknike dhe didaktike, mbi ndërhyrjet e përshtatshme për nevojat e tua dhe mbi mundësinë e një plani studimi individual, për të arritur objektivat që ke...

...tutori...

...çdo fakultet emëron një Docent si Tutor, të cilit mund ti referohesh dhe që është i gatshëm për të të ndjekur krah për krah gjatë periudhës së studimit dhe të ndihmon të zgjidhësh problemet kritike që mund të të dalin; këta tutora bashkëpunojnë me Delegaten e Rektorit, me të cilën janë në kontakt të përhershëm për të gjetur zgjidhje optimale...

...tutorë të barabartë...

...janë studentë që marrin pjesë në një Garë që bëhet dy herë në vit dhe vihen në dispozicion për të të ndjekur krah për krah, ndjekin një Kurs formimi nëpërmjet shërbimit Le Eli-Che, emërohen nëpërmjet një dekreti të Rektorit "Tutorë të barabartë", zhvillojnë një aktivitet bashkëpunimi me pagesë për 150 orë dhe kujdesen për ty gjatë periudhës së studimit; nga ana jote duhet vetëm të bësh kërkesën për të patur një tutor, nga e jona...

...transportimi jashtë...

...kemi një autobus të posatshëm për zhvendosjen në selitë universitare edhe për djemtë që janë në karroca, një organizim rezervimesh javore për të vendosur oraret e efektshme për transportimin tënd, kemi motorë elektrikë me një vënd ose me dy vënde, për personin që është me aftësi të kufizuara dhe për shoqëruesin e tij/tutorin e barabartë, një mjet të vogël që lëviz nëpërmjet një zinxhiri, shkallë nëpërmjet të cilave ngjiten karrocet, platforma, edhe një karrocë që paloset...

...transportimi i brëndshëm dhe pengesat arkitektonike...

...brënda në Fakultet duhet të lëvizësh lehtësisht: ndërkohë është e detyrueshme që të rrëzohen pengesat, edhe pse në godinat e reja dhe në strukturat e shërbimeve këto NUK ndërtohen, çdo Vit Akademik bëhet një plan i imët për të rrëzuar ato që, edhe pse janë një numër i vogël, janë pengesa akoma të pranishme në godinat historike; nga ana e Universitetit i kushtohet një vëmendje e përpiktë dhe në rast se na ka shpëtuar ndonjë e tillë, njoftoni menjëherë Delegaten, e cila vepron me Zyrën teknike për të gjetur një zgjidhje për këtë problem, dhe një "strehim të arsyeshëm", siç është e parashikuar nga Marrëveshja e OKB-së...

...strehime...

...konvikte, mensa, bursa studimi, janë shërbime të Azienda Regionale (Kompanisë së Krahinës) dell'Emilia Romagna për të Drejtën e Studimeve të Larta, sot quhet ER.GO, me seli territoriale në Parma, Tel. 0521.2139, utentipr@er-go.it, e cila ofron nëpërmjet konkursesh edhe burime strehimi, ekonomike dhe orientimi për punë...